



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 857/1 Prot.

Tiranë, më 16.10.2023

VENDIM

Nr. 38, DATË 16/10/2023

PËR

**“RIALOKIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË MASTER, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38 dhe neni 69 e në vijim, nisur nga kërkesat e Dekanëve (bashkëngjitur), konkretisht të FAS me Nr. 857 Prot., datë 09.10.2023 dhe të FAB me Nr. 867 Prot., datë 11.10.2023 mbi rialokimin e kuotave të miratuara nga Senati Akademik me Vendimin Nr. 10, datë 09.02.2023 “Për deklarimin e kuotave të pranimit të studentëve të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Arteve, Master i Shkencave dhe Master Profesional për vitin akademik 2023-2024, në Universitetin e Arteve”, pasi i diskutoi kërkesat e fakulteteve,

V E N D O S I:

1. Rialokimi e kuotave të pranimit të studentëve të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master, për vitin akademik 2023-2024, në Universitetin e Arteve, si më poshtë:
  - Programi i studimit Regji Teatri dhe Spektakli dhe Mësuesi merr 3 (tre) kuota të pashfrytëzuara në programet e studimit Regji Filmi dhe TV dhe Mësuesi (1 kuota) si dhe Skenografi – Kostumografi dhe Mësuesi (2 kuota).
  - Programi i studimit Skulpturë Qeramikë dhe Mësuesi kalon 1 (një) kuota të parashikuar për “Kandidatët nga Trojet” tek “Kandidatët brenda territorit të vendit”.
2. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca si dhe të përcillet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI

Prof. Asoc. Genci FUGA

Erlind FUSHA (Student FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)